



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVO BAR ASSOCIATION

Në mbështetje të nenit 150 dhe 152 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës, nenit 7, 9, 29 dhe 35 të Rregullores për stafin e OAK-së, Këshilli Drejtues i OAK-së shpall:

KONKURS

Pozita: Prokuror Disiplinor

Koeficienti: 12

I. Kushtet:

Përveç kushteve themelore për krijimin e marrëdhënies së punës, kandidati duhet të ketë:

1. Fakultetin Juridik (katërvjeçar ose bachelor + master);
2. 3 vite përvojë pune;
3. Të ketë të dhënë provimin e jurisprudencës;
4. Njohja e punës me kompjuter e obligueshme;
5. Njohja e gjuhëve zyrtare (njohja e gjuhës angleze përparësi).

II. Detyrat dhe përgjegjësitë:

Prokurori Disiplinor kryen këto punë dhe detyra:

- Pranon dhe shqyrtimin e çdo fletëparaqitje ndaj avokatit apo praktikantit të avokatisë duhet përfshirë iniciimin dhe shqyrtimin ex-officio të rastit;
- Përcakton nëse Zyra e Prokurorit Disiplinor ka juridiksion ndaj çështjes;
- Bën hetimin e çdo fletëparaqitje, ndaj të cilës ka juridiksion;
- Raporton rezultatet e hetimit në Komision Disiplinor;

- Në rastet kur Zyra e Prokurorit Disiplinor përcakton ekzistimin e arsyes së bazuar për ndjekje disiplinore, për përfaqësimin e interesave të OAK-ut në ndjekjen disiplinore të çështjes para Komisionit disiplinor;
- Parashtron ankesat kundër vendimeve të shkallës së parë kur konsideron se ka arsye të bazuar;
- Kryen punë të tjera të ngarkuara nga Drejtori Ekzekutiv.

Kohëzgjatja e punësimit:

Punësimi është me afat të pacaktuar, pas përfundimit me sukses të periudhës provuese prej 6 (gjashtë) muajsh.

Data e mbylljes së konkursit:

Konkursi është i hapur deri më 01 korrik 2024.

Paraqitja e dokumentacionit:

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në zyrat e Odës së Avokatëve të Kosovës, Rr. “Bekim Fehmiu pn.”, Kati IV, Prishtinë ose përmes e- mailit: info@oak-ks.org.

Dokumentacionit i bashkëngjiten: CV-ja, një letër motivuese, dy referenca, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumente të tjera të nevojshme.

Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen.

Vetëm kandidatët të cilët hyjnë në listën e ngushtë për testim dhe intervistë do të informohen me shkrim ose përmes telefonit.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë, duhet t’i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Për informata më të hollësishme të interesuarit mund të drejtohen me anë të e-mail adresës: info@oak-ks.org ose në numrat e telefonit: +383 38/610 101, çdo ditë pune prej orës 08:00 – 16:00.

Kërkesat e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.